



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Sh.II.nr.1332/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve N.N.SH.”P&I” me seli në Kaçanik, dhe N.P.P.N”NPE-ING” me seli në Pejë, të cilat i përfaqëson sipas autorizimi Av. Xh.A. dhe Av. J.B., kundër të paditurës Komuna e Pejës, e përfaqësuar sipas autorizimit nga Av. D.S. nga Prishtina, për shkak të zgjidhjes së kontratës për shkak të mos përmbushjes, dhe kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike IV.C.nr.457/2019, të datës 17.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e paditësve N.N.SH.”P&I” me seli në Kaçanik, dhe N.P.P.N”NPE-ING” me seli në Pejë PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike IV.C.nr.457/2019, të datës 17.02.2021, dhe çështja i kthehet Dhomës së Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka vendosur si në vijim:

I. Miratohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve “N.N.SH.”P&I” me seli në Kaçanik, dhe N.P.P.N”NPE-ING” me seli në Pejë, si e bazuar ashtu që Detyrohet e paditura Komuna e Pejës, që paditëseve t’ua paguaj borxhin në shumën prej 2,700.00€, në emër të shpenzimeve për punët përgatitore, me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga data 25.09.2017, e deri në pagesën definitivë, brenda afatit prej 7 ditëve nga data e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

II. Zgjidhet kontrata e lidhur me dt.13.09.2017 e emërtuar si Kontratë me nr.635/17/3083/511, me nr. të brendshëm 635/17/101/511, për ndërtimin e palestrës nacionale të xhudos në Pejë

III. Refuzohet pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve “N.N.SH.”P&I” me seli në Kaçanik, dhe N.P.P.N”NPE-ING” me seli në Pejë, që e paditura “Komuna e Pejës” me seli në Pejë, që t’u paguhet borxhi në emër të shpenzimeve të krijuar për sigurime shumen prej 3,185.40€, si dhe, në emër të fitimit të humbur shumen prej 213,631.01€, me

kamat ligjore prej 8% duke filluar nga data kur janë ndërpre punimet me 13.08.2019,e deri në pagesën definitive brenda 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET, e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, t'iu paguaj paditësit shpenzimeve gjyqësore në shkallën prej 50%, të shpenzimet gjyqësore ne bazë te suksesit ne procedurë në shumën prej prej 2.811.12 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë paditësit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shpenzimeve të procedurës, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoje ankesën e paditësve si të bazuar, dhe ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar, apo aktgjykimin ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në Ankesë nuk ka parashtruar e paditura.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi “N.N.SH.”P&I” me seli në Kaçanik, dhe N.P.P.N”NPE-ING” me seli në Pejë, me datën 13.08.2019, në këtë Gjykatë kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Pejës, për kompensimin e dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës. Sipas padisë, paditësit pretendojnë se me datën 13.09.2017, kanë lidhur “Kontratë për Ndërtimin e Palestrës Nacionale të Xhudos” në Pejë me nr.635/17/3083/511 dhe nr. te brendshëm 635/17/101/511,me një çmim kontraktues prej 1.040.044.23€. Paditësi duke i respektuar ne tersi detyrimet e marra në bazë të kontratës i kishte filluar punimet me dt.19.09.2017, duke bërë përgatitjet fillestare për fillimin punimeve ndërtimore, përkatësisht duke e bërë rrethimin e vend punishtes, vendosjen e zyrës së përkohshme, largimin e makinave që ishin te vendosura në lokacionin(pasi qe lokacioni ishte auto parking) dhe punët tjera të cilat ishin të nevojshme për përgatitjen e vend punishtes. Paditësi, gjatë përgatitjeve për fillim e punimeve ne nderimin e objektit, kishte hasur në rezistencë nga ana e komunitetit të cilët kishin kërkuar ndërprerjen e punimeve(me dt.22.09.2017) kurse me dt.25.09.2017, paditësve i’u është ndaluar puna nga ana e mbikëqyrësit të projektit me anë të vendimit të dt.13.02.2019, për shkak se komuniteti kishte kërkuar që të ndaloheshin punimet. Paditësve, fillimisht i është thënë se ndërprerja e këtyre punime është e përkohshme, por më vonë i ishte thënë se kjo ndërprerje do te vazhdoj deri në gjetjen e një lokacioni te ri. Paditësit e kishin mirëkuptuar arsyetimin e te paditurës, dhe kishin pritur një kohë relativisht të gjatë deri ne gjetjen e lokacionit te ri. Paditësit nuk i janë paguar as shpenzimet për periudhën sa kishte punuar në përgatitjen e vend punishte të përshkruar si në ditarin e punës duke i shkaktuar dëme te konsiderueshme.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadia e paditësve “N.N.SH.”P&I” me seli në Kaçanik, dhe N.P.P.N”NPE-ING” me seli në Pejë, ashtu që e ka detyruar të paditurën Komuna e Pejës, që paditëseve t’ua paguaj borxhin në shumën prej 2,700.00€, në emër të shpenzimeve për punët përgatitore, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 25.09.2017, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditëve nga data e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Me pikën II të dispozitivit është vendosur që të zgjidhet kontrata e lidhur me dt.13.09.2017 e emërtuar si Kontratë me nr.635/17/3083/511, me nr. të brendshëm 635/17/101/511, për ndërtimin e palestrës nacionale të xhudos në Pejë. Me pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është refuzuar pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve “N.N.SH.”P&I” me seli në Kaçanik, dhe N.P.P.N”NPE-ING” me seli në Pejë, që e paditura “Komuna e Pejës” me seli në Pejë, që t’u paguhet borxhi në emër të shpenzimeve të krijuar për sigurime shumen prej 3,185.40€, si dhe, në emër të fitimit të humbur shumen prej 213,631.01€, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data kur janë ndërpre punimet me 13.08.2019, e deri në pagesën definitive brenda 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërkaq me pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, t’u paguaj paditësve shpenzimeve gjyqësore në shkallën prej 50%, të shpenzimet gjyqësore në bazë të suksesit në procedurë në shumën prej prej 2.811.12 €.

Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e atakuar, ka konstatuar se me rastin e vendosjes së kësaj çështje ka konstatuar se paditësit kanë bërë disa përgatitje në objekt sipas ditarëve ndërtimor, gjë që është aprovuar kërkesa për kompensimin e dëmit, konform dispozitave të Nenit 8 par.1, 106 par.1 dhe 173 par.1 të LMD-së. Sa i përket zgjidhjes së kontratës, gjykata e ka aprovuar propozimin e paditësit bazuar në dispozitën e Nenit 106 par 1 të LMD-së (2012), Ndërkaq, gjykata e shkallës së parë fitimin e humbur nuk ia ka pranuar palës paditëse nga shkak se pala e paditur nuk ka qenë fajtoreshë me rastin e ndërprerjes së punimeve, andaj edhe nuk ekziston lidhja kauzale në mes dëmit dhe fajit.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhomat e shkallës së dytë gjejnë se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas vlerësimit të Dhomave të Shkallës së Dytë të metat e aktgjykimit evidentohen në faktin se gjykata e shkallës së parë, në dispozitiv ka vendosur për zgjidhjen e një kontrate pa pasur tagër ligjor për një gjë të tillë. Nga shkresat e lëndës rezulton se palët kishin lidhur kontratë të prokurimit, për ndërtimin e palestrës nacionale të xhudos në Pejë, me nr.635/17/3083/511, me nr. të brendshëm 635/17/101/511. Sipas kontratës – Kushteve të Veçanta nga Pjesa III e saj, Neni 10 par.2 rrjedh se kontrata ishte e lidhur me afat të caktuar kohorë. Nga shkresat e lëndës nuk është kontestues fakti se e paditura i ka ndaluar punimet e filluara nga ana e paditëses sipas kontratës, me arsyetimin se MMPH nuk lejon ndërtimin e “Qendrës Nacionale të Xhudos” pasi që në ngastrën kadastrale të destinuar nuk lejohej destinimi tjetër. Gjykata e shkallës së parë ka marr vendim kontradiktor pasi që fillimisht e njeh kompensimin e dëmit për dëmin material si pasojë e shpenzimeve në emër të punëve përgatitore, duke vendosur edhe për zgjidhjen e kontratës, ndërkaq nuk ia njeh paditëses fitimin e humbur.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare kur ka ardhur deri te përfundimi për marrjen e qëndrimit të tillë që paditësit t’i njihet një kategori e dëmit, ndërsa fitimi i humbur që po ashtu hyn në kategorinë e dëmit material t’i refuzohet. Për më tepër, gjykata më e ulët nuk jep fare arsye se si ka ardhur deri te konstatimi për marrjen e vendimit deklarativ për zgjidhjen e kontratës, kur një gjë e tillë do të duhej të vlerësohej në kontekst të rrethanave të ndryshuara, apo edhe sipas fuqisë së ligjit, por në asnjë rast nuk i takon që këtë ta vendos gjykata.

Në rastin konkret është i qartë fakti se kontrata mes palëve ka qenë kontratë e dyanshme detyruese mes palëve dhe se e njëjta ka mbetur e pa përmbushur. Mirëpo, gjykata fare nuk është lëshuar në vlerësimin se në anën e cilës palë kanë qenë shkaqet për mos përmbushje. Vetëm vlerësimi i kësaj rrethane do të mund të sillte vlerësimin e drejtë se cilës palë i takon kompensimi.

Me nenin 106 të LMD-së është paraparë se *“Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e dëmit.”*

Referuar dispozitës së lartcekur, gjykata e shkallës së parë është dashur në fillim të vlerësojë se cila nga palët nuk e ka përmbushur detyrimin e vet ashtu që të përcaktohet se cila nga palët ka cilësinë e kreditorit në këtë raport detyrimor. Vetëm pas kësaj, mund të përcaktohet se cila palë ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, zgjidhjen e kontratës apo të përcaktohet nëse kontrata zgjidhet sipas vetë ligjit. Krahas kësaj, detyrimi që pala e dëmtuar të kompensohet është i pamohueshëm, e në veçanti edhe kompensimi i dëmit për shkak të fitimit të humbur.

Pjesa e dispozitës së nenit 106 kur thuhet se *“ kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e saj”*, nuk rregullon momentin se kur kreditori në raportin detyrimor arrin/fiton të drejtën e përcaktuar me këtë dispozitë, por në mënyrë të përgjithësuar janë rregulluar pasojat e mospërmbushjes së

debitorit. Domethënë, kërkesën për përmbushje kreditori e fiton menjëherë kur lind e drejta e tij, respektivisht detyrimi i debitorit, nëse ndryshe nuk është përcaktuar me kontratë, apo me ligj, dhe nëse qëllimi i punës, natyra e detyrimit dhe rrethanat e tjera nuk kërkojnë afat të caktuar dhe jo menjëherë “kur pala tjetër nuk e përmbush detyrimin”.

Rrjedhimisht, gjykata nuk ka vlerësuar fare nëse në rastin konkret kemi të bëjmë me kontratë afati i së cilës është element thelbësor apo jo. Varësisht nga kjo, më pas rrjedh konkludimi nëse duhet të ndërmerret ndonjë veprim që kontrata të zgjidhet, apo se e njëjta zgjidhet sipas vet ligjit. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar fare rrethanat të cilat kanë qar deri në mospërmbushjen e kontratës, nëse mospërmbushja ekziston në anën e njëres palë dhe cilës nga palët në kontratë.

Kolegji vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar me të cilin është aprovuar vetëm kërkesa për dëmin material dhe është zgjidhur kontrata nga ana e gjykatës, paraqet vendim kontradiktor me vetveten, pasi që gjykatës në asnjë rrethanë nuk i takon të zgjidh kontratën mes palëve në mënyrë deklarative, por një gjë e tillë bëhet në mënyrë të njëanshme me deklaratë të palëve si veprim konkludent i palëve, por sipas vetë ligjit. Fakti se gjykata e shkallës së parë i ka njohur dëmin material palës paditëse, është e paqartë se në çfarë rrethana ka ardhur deri te konstatimi se paditësit nuk i takon fitimi i humbur.

Kolegji i kësaj gjykate konstaton se fitimi i humbur konsiston në pengimin e shtimit të pasurisë së të dëmtuarit. Në kuptim të dispozitave të nenit 173 të LMD-së, është fitimi që i dëmtuari do ta kishte arritur sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, po të mos kishte pasur veprim të dëmshëm.

Lidhur me këtë, kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar është përfshirë edhe me shkelje nga neni 183 i LPK-së, sepse gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike. Kjo për faktin se pa u lëshuar fare në vlerësimin e fakteve të mospërmbushjes së kontratës, e ka refuzuar fitimin e humbur të llogaritur nga ekspertiza financiare, nga shkaku se e paditura nuk është fajtores për ndërprerjen e punimeve nga pala e paditur, por faktori ka qenë jashtë vullnetit dhe dëshirës së palës së paditur. Kolegji pa ndërhyrë në vlerësimin e këtillë ta faktit të rrethanës për të cilën kontrata nuk ka mundur të përmbushet nga e paditura, vlerëson se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, pasi që gjykata fare nuk i ka marr parasysht as kushtet ligjore nga Neni 116 i LMD-së dhe as kriteret që pala duhet t'i ndjekë për të kërkuar zgjidhjen e kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara. Në rrethanat e rastit konkret, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar fajin për mospërmbushjen e kontratës pa pasur fare kërkesë nga pala e paditur.

Në rrethanat e rastit konkret, sipas Nenit 8 par. 2 të LPK-së, gjykata ka për obligim që me ndërjegje dhe me kujdes ta çmojë çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, ashtu që gjendja faktike të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe në këtë drejtim duhet të kujdeset që të administrohen të gjitha faktet të cilat janë thelbësore për epilogun e kontestit. Andaj, qëndrojnë

pretendimet e të paditurës se gjykata e shkallës së parë fare nuk i ka marrë parasysh provat të cilat fillimisht e vërtetojnë gjendjen faktike sa i përket shkaqeve të mos përmbushjes së kontratës, e më pas as provat për të përcaktuar dëmin eventual të shkaktuar.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga Nenit 183 par. 1 dhe Neni 160 par. 3 dhe 4 të LPK-së, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, dhe si rrjedhojë gabimisht është aplikuar edhe e drejta materiale, aplikimin e drejtë të secilës në bazë të nenit 194 të LPK, gjykata e shkallës së dytë e vlerëson sipas detyrës zyrtare, andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të eviton kundërthëniet ekzistuese në dispozitiv ashtu që fillimisht duhet të vlerësojë kushtet kontraktuese, rrethanat dhe shkaqet për shkak të të cilave ka ardhur deri te mospërmbushja e kontratës, varësisht nga kjo sipas llojit të kontratës të përcaktojë se a kemi të bëjmë me kontratë me afat të caktuar sipas të cilës shkëputja ndodh *ex lege* – gjë që gjykatës së shkallës së parë në asnjë rrethanë nuk i takon ta zgjidh kontratën në mënyrë konstitutive. Pasi të jenë vlerësuar aspektet e zgjidhjes së kontratës dhe efektet e saj, gjykata mund të vendos në mënyrë meritore për kategoritë e dëmit bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke vlerësuar nëse plotësohen kushtet për shpërblimin e dëmit për secilën kategori të dëmit.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1332/23, me datë 15.02.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova